



UDHËZUES
PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE
MBI FINANCIMIN E TERRORIZMIT



AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

Shtator/2024

UDHËZUES OJF MBI FT

PËRMBAJTJA

I. QËLLIMI DHE PËRDORIMI I UDHËZUESIT	3
II. VEÇORITË E OJF	4
III. KUADRI LIGJOR/STANDARDET NDËRKOMBËTARE	5
3.1 Parashikimet ligjore për OJF dhe Financimin e Terrorizmit	5
3.2 Financimi i Terrorizmit	6
3.3 Standardet Ndërkombëtare/ FATF Rekomandimi 8 për OJF	7
IV. CËNUESHMËRIA E OJF-ve/METODAT E ABUZIMIT FT	8
4.1 Arsyet pse sektori i OJF është më i cenueshëm për FT	8
4.2 Metodatat e abuzimit të OJF për FT	9
4.3 Faktorët që rrisin rrezikun për keqpërdorim/abuzim nga FT	11
4.4 Indikatorët e riskut	12
V. MASAT E OJF PËR PARANDALIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT	13
5.1 Transparenca	14
5.2 Njohja e palëve bashkëpunuese dhe donatorëve	14
5.3 Monitorimi i programit/projektit	15
5.4 Përdorimi i kanaleve të sigurta financiare të pagesës	15
5.5 Njohja e palëve të treta	15
5.6 Njohja e përfituesve të shërbimeve	17
5.7 Situatat e emergjencave	17
5.8 Kryerja e trajnimeve në fushën e FT dhe e vlerësimeve të brendshme të riskut	17
VI. ROLI I AGJENCISË SË INTELIGJENCËS FINANCIARE	22
VII. ROLI I QENDRËS KUNDËR ESKTREMIZIT TË DHUNSHËM	23
VIII. TIPOLOGJI	26
IX. PUBLIKIME NË NIVEL VENDI DHE NDËRKOMBËTAR	31

I. QËLLIMI DHE PËRDORIMI I UDHËZUESIT

Ky dokument është hartuar nga AIF në bashkëpunim me sektorin publik dhe atë privat (përfshirë dhe konsultimin me përfaqësues të OJF), në ndihmë të sektorit të organizatave jofitimprurëse (OJF) me qëllimi ndërgjegjësimin e tyre për rrezikun nga keqpërdorimi/abuzimi i financimit të terrorizmit.

Krijimi i këtij udhëzuesi është mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare, publikimet e FATF për sektorin e OJF-ve, Vlerësimin Kombëtar të Riskut të Shqipërisë të vitit 2023, tipologjitë e hasura ndër vite nga raportimet e aktiviteteve të dyshimta (RAD), eksperiencia e organeve të zbatimit të ligjit, etj.

Udhëzuesi nuk është një dokument detyrues por ka si qëllim parësor të njohë OJF-të me konceptin e financimit të terrorizmit, njohjen e legjislacionit shqiptar për financimin e terrorizmit, detyrimet ligjore të tyre në kuadër të luftës kundër FT, si mund të ndikojë FT në keqpërdorimin e tyre, metodat e përdorura më shpesh për abuzimin e tyre, mënyra/metodat për vlerësimin e riskut të brendshëm, masa të sugjeruara për parandalimin e keqpërdorimit të tyre si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë. Gjithashtu ky dokument mund të përdoret nga institucionet mbikëqyrëse si bazë për trajnimin e OJF-ve në parandalimin e financimit të terrorizmit.

Në mënyrë të përmblodhur ky udhëzues ka për qëllim:

- Të rrisë nivelin e ndërgjegjësimin të OJF-ve mbi rrezikun e FT;
- Të njohë OJF-të me metodat/tipologjitë më të përdorura për abuzimin/keqpërdorimin e tyre për FT;
- Të njohë OJF-të me praktikat më të mira kombëtare/ndërkombëtare për zbutjen e riskut të FT;
- Të ndihmojë OJF-të për të kuptuar dhe zbatuar kërkesat ligjore në lidhje me parandalimin e financimit të terrorizmit.

II. VEÇORITË E OJF

“Organizata jofitimprurëse” sipas legjislacionit vendas, kuptohet shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti¹. Organizatat jofitimprurëse, fitojnë personalitetin juridik pasi të jenë themeluar dhe regjistruar në gjykatë, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Të njëjtave procedura të regjistrimit u nënshtrohen edhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja².

OJF-të janë një kategori me karakteristika të veçanta që ndryshojnë nga subjektet tregtare apo entet publike. Disa nga karakteristikat kryesore dalluese të tyre mund të përmendim:

- **Natyrën “jofitimprurëse”:** Karakteristika kryesore që i dallon OJF-të nga sektori privat është se nuk kanë qëllim fitimi dhe kanë objektiva kryesisht humanitare e në zhvillim të komunitetit, jo objektiva ekonomike apo për rritjen e fitimit. Të ardhurat ose pasuritë e organizatave jofitimprurëse, kur ka të tilla, përdoren vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në statutin e organizatës dhe nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar, material nga të ardhurat dhe fitimet e organizatës jofitimprurëse, përveç detyrimeve në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të organizatës jofitimprurëse³.
- **Përdorimi i fitimeve nëse ka:** Nëse organizata jofitimprurëse, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, realizon fitime apo për shkak të natyrës së vet organizatës mund të teprojnë fondet nga ushtrimi i aktiviteti, ato duhet të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit⁴.
- **Financimi:** Burimet e të ardhurave të organizatës jofitimprurëse janë të ardhurat nga kuotizacioni kur ka të tilla, fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës jofitimprurëse. Organizatat jofitimprurëse bëjnë shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë, për të cilin janë krijuar, si dhe për drejtimin e mirëmbajtjen e pasurisë së tyre.⁵ Nga ana tjetër Organizata jofitimprurëse mund të zhvillojë veprimtari ekonomike pa qenë nevoja që të krijojë një subjekt të veçantë për këtë qëllim, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimet e organizatës jofitimprurëse, të jetë deklaruar si një nga burimet e të ardhurave dhe me kusht që kjo veprimtari të mos përbëjë qëllimin primar të veprimtarisë së organizatës⁶.
- **Lehtësimi dhe përjashtimi nga detyrimet fiskale:** Organizatat jofitimprurëse, pavarësisht nga forma e organizimit, qëllimi që ndjekin dhe veprimtaritë që ushtrojnë, përjashtohen nga

¹ Neni 2 i ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 ‘Për organizatat jofitimprurëse’

² Neni 13 i ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 ‘Për organizatat jofitimprurëse’

³ Neni 35 i ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 ‘Për organizatat jofitimprurëse’

⁴ Neni 36 i ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 ‘Për organizatat jofitimprurëse’

⁵ Neni 35 i ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 ‘Për organizatat jofitimprurëse’

⁶ Neni 36 i ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 ‘Për organizatat jofitimprurëse’

tatimi mbi të ardhurat që realizohen nga dhurimet dhe kuotat e anëtarësisë. Gjithashtu edhe personat fizikë dhe juridikë që japin ndihmesë me dhurime në favor të organizatave jofitimprurëse, gëzojnë të drejtën e lehtësirave, lidhur me tatimin mbi të ardhurat sipas ligjit⁷.

- **Stafi i OJF:** një pjesë e stafit apo edhe shumica e stafit mund të kryejë aktivitete për/ose llogari të OJF pa shpërblim, si anëtarë ose vullnetarë.
- **Parimi i pavarësisë nga shteti:** Organizatat jofitimprurëse e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur nga organet dhe interesat shtetërorë. Nga ana tjetër shteti mbështet dhe nxit veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se disa OJF nuk mund të pranojnë financime nga qeveria për projekte apo veprimtari të ndryshme, për sa kohë veprimtaria e tyre nuk kontrollon nga shteti

III. KUADRI LIGJOR/STANDARDET NDËRKOMBËTARE

3.1 Parashikimet ligjore për OJF dhe Financimin e Terrorizmit

3.1.1 OJF

Siç është përmendur edhe më sipër në Shqipëri me “Organizata jofitimprurëse” kuptohet shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti. Veprimtaria e tyre konsiston në çdo veprimtari ekonomike ose joekonomike me kusht që të ardhurat ose pasuritë e organizatave jofitimprurëse, kur ka të tilla, të përdoren vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në statutin e organizatës. Gjithashtu sipas kuadrit ligjor organizatat jofitimprurëse të huaja lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin shqiptar edhe nëpërmjet themelimit dhe regjistrimit sipas së drejtës shqiptare të një dege të tyre ose të një organizate jofitimprurëse të re.

Rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e tyre, apo edhe procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, si dhe rregullat për mbajtjen e regjistrimit të tyre për organizata jofitimprurëse, të cilat kanë detyrimin për t’u regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, përcaktohen në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”.

Organizatave jofitimprurëse regjistrohen në administratën tatimore,⁸ pasi kanë kryer më parë regjistrimin, në përputhje me legjislacionin e fushës. (Themelimi, Regjistrimi në Gjykatë dhe në DPT).

⁷ Neni 40 I ligjit Nr.8788, datë 7.5.2001 ‘Për organizatat jofitimprurëse’

⁸ Neni 4 i ligjit nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e OJF”, pika 2 parashikon se: Regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse krijohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe administrohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore. Të gjitha të dhënat, kërkesat për regjistrim dhe dokumentet shoqëruese,

Organ mbikëqyrës i OJF-ve, në kuptim të ligjit që mbulon parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, konsiderohen organet tatimore. Raportet e kontabilitetit, të hartuara nga OJF-të për përdorimin e fondeve të donatorëve, si dhe pasqyrat financiare janë objekt kontrolli nga organet tatimore, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (tashmë AIF) sa herë që është e nevojshme.⁹

Në zbatim të ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 ‘Për organizatat jofitimprurëse’ i ndryshuar organi më i lartë vendimmarrës i OJF:

- mbikëqyr veprimtarinë e organizatës jofitimprurëse, me qëllim parandalimin e përdorimit të burimeve të organizatës për qëllime terroriste, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit¹⁰;
- bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (tashmë AIF) për të siguruar që organizatat partnere dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale nuk përdoren apo manipulohen për qëllime terroriste¹¹.

Për më tej ligji nr. 9917 datë 19.05.2008 i ndryshuar ‘Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit’ i ndryshuar parashikon se: ‘Çdo autoritet që regjistron, licencon dhe mbikëqyr veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse duhet të raportojë menjëherë tek autoriteti përgjegjës çdo dyshim, informacion ose të dhëna, lidhur me pastrim parash ose financim terrorizmi’¹².

3.2 Financimi i Terrorizmit

Për rëndësinë dhe pasojat e mundshme që ka fusha e terrorizmit, financimit të tij apo aktiviteteve të lidhura me to, legjislatori ka parashikuar një sërë veprash penale, që janë në linjë edhe me akte ndërkombëtare të ratifikuara.

Parashikimet ligjore për vepra penale të terrorizmit të paraqitura në mënyrë të përmbledhur:

- **‘Vepra me qëllime terroriste’**, është parashikuar si vepra penale në nenin 230 të kodit penal të Shqipërisë dhe përkufizohet si: *“Vepra me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare”*.

pavarësisht nëse janë paraqitur në formë shkresore apo elektronike sipas këtij ligji, regjistrohen dhe ruhen në regjistër në formë elektronike.

⁹ Neni 41 I ligjit Nr.8788, datë 7.5.2001 ‘Për organizatat jofitimprurëse’ I ndryshuar

¹⁰ Neni 20

¹¹ Neni 21

¹² Neni 20

- **‘Financimi i Terrorizmit’** është parashikuar si vepër penale në nenin 230/a të kodit penal dhe përkufizohet si: *“Dhënia ose grumbullimi i fondeve, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me qëllimin që ato të përdoren ose duke ditur se ato do të përdoren, plotësisht ose pjesërisht: a) për të kryer vepra me qëllime terroriste; b) nga një organizatë terroriste; c) nga një terrorist i vetëm”*.

Gjithashtu Kodi Penal i Shqipërisë parashikon një sërë veprash të tjera të lidhura me terrorizmin apo financimin e terrorizmit si: ‘Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin’ neni 230/b, ‘Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit’ neni 231, ‘Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste’ neni 232/a, ‘Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj’ neni 265/a, ‘Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj’ neni 265/b, parashikime të cilat kanë pasur një efekt frenues.

3.3 Standardet Ndërkombëtare/ FATF, Rekomandimi 8 për OJF

Vendi ynë është i angazhuar për të parandaluar terrorizmin brenda territorit të tij dhe më gjerë. Shqipëria ka një detyrim ndërkombëtar për të luftuar financimin e terrorizmit, si një vend palë në Konventën Ndërkombëtare për Ndalimin e Financimit të Terrorizmit dhe në pajtim me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së kundër terrorizmit.

Shqipëria është gjithashtu anëtare e Komitetit për Masat Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (*Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës*) i cili monitoron zbatimin nga anëtarët e tij të standardeve të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF), dhe në këtë kuadër zhvillon dhe mbështet politika për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

FATF ka përcaktuar një sërë rekomandimesh për luftën kundër PP/FT të cilat janë kthyer në standarde ndërkombëtare. Rekomandimi 8 është ai i cili përcakton mekanizma për sektorin e OJF-ve dhe ka për qëllim të sigurojë që OJF-të të mos abuzohen nga terroristët dhe organizatat terroriste:

- (i) të shfaqen si subjekte të ligjshme;
- (ii) të shfrytëzojnë subjektet e ligjshme si kanalet për financimin e terrorizmit, duke përfshirë këtu edhe shmangien e masave për ngrirjen e aseteve; ose
- (iii) për të fshehur ose devijuar fondet e destinuar për qëllime të ligjshme në qëllime terroriste.

Rekomandimi 8 nuk aplikohet për të gjithë organizatat të cilat ushtrojnë veprimtari jofitimprurëse por vetëm për ato organizata që janë të angazhuara në mbledhje ose shpërndarje fondesh për qëllime bamirësie, fetare, kulturore, arsimore, sociale ose vëllazërie, ose për kryerjen e llojeve të

tjera të veprimtarisë që klasifikohen në 'punët e mira', fusha që besohet se kanë një rrezik të shtuar.

Në këtë rekomandim FATF përcakton se vendet duhet të kenë mekanizmat e duhura (vlerësime risku, masa të bazuara në risk etj.) për mbrojtjen e OJF-ve nga keqpërdorimi/abuzimi i FT.

Gjithashtu FATF këshillon/sugjeron vendet që OJF:

- a) të kenë masa vetërregulluese dhe masat e kontrollit të brendshëm;
- b) të përdorin sisteme financiare formale për transferimin e fondeve;

IV. CËNUESHMËRIA E OJF-ve/METODAT E ABUZIMIT FT

Spektori i OJF-ve, organizohet në forma të ndryshme dhe kryen një larmi veprimtarish. Në këtë udhëzues fokusi do të jetë vetëm tek ato OJF të cilat sipas përkufizimit të FATF janë të angazhuara në mbledhje ose shpërndarje fondesh për qëllime bamirësie, fetare, kulturore, arsimore, sociale ose vëllazërie, ose për kryerjen e llojeve të tjera të veprimtarisë që klasifikohen në 'punët e mira', pasi për shkak të karakteristikave të veprimtarisë përbëjnë një rrezik potencial ekspozimi ndaj abuzimit apo keqpërdorimit nga financimi i terrorizmit.

Në vijim parashtrohen arsyet se pse kjo kategori e OJF-ve në nivel ndërkombëtar janë më të cenueshme për financimin e terrorizmit, metodat e vlerësuara si më të përdorura për FT, faktorët të cilët rrisin riskun për FT, indikatorë rreziku të cilat ndihmojnë OJF-të për të identifikuar nëse vetë ato janë objekt keqpërdorimi për FT.

Ky material nuk ka për qëllim të paragjykojë, cenojë apo ndikojë negativisht në aktivitetet legjitime të sektorit të OJF-ve - por synon t'u sigurojë OJF-ve informacion të mjaftueshëm dhe ndihmës në parandalimin e përfshirjes në FT (pasi ato mund të ndeshen dhe/ose të ekspozohen ndaj TF).

4.1 Arsyet pse sektori i OJF është më i cenueshëm për FT

Referuar situatës dhe karakteristikave të OJF në vendin tonë vlen të parashtrojmë se:

- Sektori i OJF dominohet nga OJF vendase, ku edhe themeluesit, përfaqësuesit ligjorë apo edhe punonjësit janë shtetas shqiptar;
- Rastet kur OJF-të e regjistruara në vendin tonë ushtrojnë veprimtarinë jashtë vendit nëpërmjet degëve janë sporadike;
- Nga një analizë e kryer në lidhje me financimin e OJF-ve të regjistruara në Shqipëri nëpërmjet transfertave (kanalit bankar) rezultoi se 80% ishin fonde nga juridiksione që vlerësohet se kanë standarde të larta të zbatimit të masave kundër FT;

- OJF-të që operojnë në Shqipëri kanë të paktën një llogari bankare, detyrim që rrjedh nga pika 1/2, neni 59 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Pjesa më e madhe e OJF-ve kanë llogari në jo më shumë se dy banka.

Pavarësisht sa është cituar më sipër, nisur nga natyra e operimit sektori i OJF mbetet i cënueshëm për financim terrorizmi. Më poshtë paraqiten disa karakteristika të evidentuara në nivel ndërkombëtar:

- Natyra e operimit të OJF që lidhet me mbledhjen e fondeve, transferimin e fondeve dhe shpërndarjen e fondeve;
- Kryerja e aktiviteteve humanitare tek shtresa në nevojë ndihmon në rekrutimin e individëve në mbështetje të veprimtarive terroriste.
- Organizimi i fushatave publike për mbledhjen e fondeve apo përfitimi/sigurimi i granateve të ligjshme nga donatorë të ndryshëm.
- Shtrirja globale e OJF-ve të caktuara ndihmon në sigurimin e fondeve apo materialeve në vende të ndryshme të botës si dhe ndihmon në kryerjen e transfertave financiare nga një vend në tjetrin me lehtësi.
- Kryerja e veprimtarive bamirëse/humanitare brenda ose pranë zonave që janë më të ekspozuara ndaj veprimtarive terroriste;
- Mungesa e Transparencës dhe Kontrollit të Brendshëm nga vet OJF-të;
- Përdorimi i Teknologjisë dhe Medias Sociale, si kanale promovimi dhe mbledhje fondesh.

4.2 Metodatat e abuzimit të OJF për FT

OJF-të mund të abuzohen/keqpërdoren për qëllime të financimit të terrorizmit me ose pa dijeni të tyre. Disa prej metodave më të përdorura për keqpërdorimin e tyre, të nxjerra nga analizimi i rasteve ndërkombëtare¹³ ku janë keqpërdorur OJF-të të cilat sipas rastit mund të jenë me dijeni apo pa dijeni, janë si më poshtë vijon:

▪ Lidhja e OJF-ve me organizata Terroriste

Një OJF, ose një individ i cili vepron në emër të OJF-së, me lidhje me një organizatë terroriste ose përkrahës të terrorizmit, mund të japë informacion, i ndihmon financiarisht, duke ligjëruar aktivitetin e tyre apo duke i mbështetur me mjete të tjera veprimtarinë e tyre.

¹³ FATF ‘Risk of Terrorist Abuse in nonprofit organization’ 2014, FATF Best Practices Combating the Abuse of Non-Profit Organizations (Recommendation 8) 2015, FATF Best Practices Combating the Abuse of Non-Profit Organizations (Recommendation 8) 2023, Public Summary FIUs Role in the Fight Against the Abuse of NPOs for TF Activities Information Exchange Working Group, Egmont Group 2024.

- *Përfaqësimi i rremë apo OJF fiktive*

Përfaqësimi i rremë ndodh kur organizatat dhe/ose individët mbledhin fonde, promovojnë kauza dhe kryejnë aktivitete të tjera në mbështetje të terrorizmit nën emrin e një OJF, që realisht është një OJF fiktive, e krijuar vetëm për qëllime terroriste.

- *Devijimi i fondeve*

Fondet e mbledhura për qëllime të OJF mund të devijohen për qëllime terroriste, apo fondet objekt bamiçese keqpërdoren për aktivitete terroriste. Kjo mund të ndodhë gjatë mbledhjes së donacioneve dhe në çdo moment kur fondet transferohen nëpërmjet palëve të ndryshme. Palët mund të jenë të brendshme (punonjës të OJF-ve) apo të jashtme (mbledhës fondesh nga palë të treta).

- *Abuzimi me programin*

Programet e financuara nga OJF-të që synojnë të mbështesin qëllime të ligjshme humanitare, sociale, arsimore, kulturore ose fetare manipulohen në fazën përfundimtare nga palë të brendshme ose të jashtme për të mbështetur terrorizmin.

- *Mbështetje për rekrutim*

Programet apo veprimtaritë e financuara nga OJF-të përdoren për të krijuar një mjedis që mbështet dhe/ose promovon aktivitete të lidhura me rekrutim terrorizmi, takime të grupeve terroriste ose përgatitje të materialeve që propagandojnë akte terroriste.

- *Përdorimi i emrit dhe statusit të një OJF-je*

Individët që mbështesin veprimtarinë terroriste mund të pretendojnë se punojnë për një OJF dhe veprojnë nën emrin e saj të mirë dhe të ligjshëm, në mënyrë që të marrin/përfitojnë mbështetjen e komunitet, ndërkohë që “mbledhin fonde” për kauzat e asaj OJF-je. Këta individë mund të përdorin OJF-në dhe/ose emrin e saj si një mburojë në dukje e ligjshme për të udhëtuar në vende të njohura si zona konflikti për t'u arritur për të marrë pjesë në aktivitete në dukje të ligjshme, por në fakt janë aktivitete në mbështetje të terrorizmit si p.sh në vendet ku janë kampet të trajnimit të terroristëve, etj.

- *Përdorimi i asetëve të OJF-ve*

Grupet/Organizatrat terroriste mund të përdorin asetet e OJF-ve për të lehtësuar/mundësuar kryerjen e veprimtarive të tyre. Si p.sh mund të përdorin automjetet e OJF-ve për të transportuar njerëz, para, armë ose materiale propagande terroriste, apo ambientet e tyre për ti ruajtur ato. Gjithashtu mund të përdorin dhe kanalet e komunikimit të OJF-ve për të kontaktuar apo takuar njëri-tjetrin.

- *Abuzimi nga brenda i një OJF*

Megjithëse kjo metodë ka më pak gjasa të ndodhë krahasua me abuzimi nga palët e treta, individët brenda një OJF-je mund të abuzojnë gjithashtu me pozicionin e tyre dhe vetë emrin e OJF-së për qëllime terrorizmi. Këtu mund përfshihet marrja e parave nga fondet e mbledhura për bamirësi dhe dërgimi ose përdorimin i tyre në mbështetje të aktiviteteve terroriste. Mund të abuzojnë me OJF-në duke punësuar/marrë si vullnetarë individë të përfshirë në veprimtari terroriste, etj.

4.3 Faktorët që rrisin rrezikun për keqpërdorim/abuzim nga FT

Disa prej faktorëve që rrisin rrezikun për keqpërdorim/abuzim nga FT janë faktorë të natyrshëm që vijnë si pasojë e llojit të aktivitetit, vendit ku ushtrohet aktiviteti, por disa prej tyre vijnë edhe si pasojë e mënyrës së operimit të brendshëm të OJF-ve.

Disa prej faktorëve të identifikuar në nivel ndërkombëtar janë të paraqitura/listuara si më poshtë:

- Operojnë në zonat e konfliktit;
- Operojnë në zona që janë në shënjestër të organizatave terroriste;
- Nuk i kryejnë aktivitetet e tyre në mënyrë transparente, struktura e menaxhimit, e personelit apo financimi i tyre nuk është transparente, si dhe nuk kanë mekanizma kontrolli funksional;
- Nuk i përmbushin detyrimet e tyre ligjore;
- Nuk informojnë publikun ose autoritetet mbikëqyrëse për aktivitetet e tyre;
- Nuk komunikojnë me autoritetet publike;
- Qarkullojnë shuma të mëdha fondesh, kryesisht në para të cash.
- Mbledhja e fondeve në monedha virtuale.

Megjithatë, është e rëndësishme të kihet parasysh se këta faktorë rreziku, ose kombinimet e tyre të mundshme, në vetvete nuk tregojnë automatikisht një abuzim të OJF-ve. Prandaj është gjithmonë e nevojshme të vlerësohet situata dhe konteksti specifik.

Duhet mbajtur parasysh gjithashtu se pasojat që rrjedhin nga përfshirja me ose pa dijeni në mbështetje/financimin e terrorizmit, apo pastrimin e parave, mund të përfshijnë humbjen e statusit si organizate jofitimprurëse, çregjistrimin e saj, dëmtimin e reputacionit dhe besimit të donatorëve.

Përveç kësaj, individët që menaxhojnë OJF-të ose edhe vetë OJF-të, mund të përballen me hetime apo dënime penale në qoftë se ata ofrojnë mbështetje financiare për një terrorist, organizatë terroriste apo akt terrorist.

4.4 Indikatorët e riskut

Pavarësisht faktit se në Shqipëri nuk janë materializuar raste të keqpërdorimit të OJF-ve është e rëndësishme që OJF-të të jenë të ndërgjegjshme ndaj riskut potencial që kanë nga FT dhe të kenë aftësi për të identifikuar elementë të cilët tregojnë se mund të jenë abuzuar nga FT.


Për t'i ardhur në ndihmë sektorit të OJF më poshtë paraqiten një sërë indikatorësh të cilët tregojnë se një OJF është/mund të jetë ekspozuar ndaj FT, të cilat nuk janë shteruese:

- ▶ Donacione të vazhdueshme nga burime të paidentifikuara;
- ▶ Donacione të mëdha pa një arsye të qartë ose të dokumentuar mund të jenë një sinjal i mundshëm i abuzimit;
- ▶ Donacione apo tentativa për donacione nga subjekte ndaj të cilëve zbatohen sanksione;
- ▶ Përfituesit e fondeve janë subjekte ndaj të cilëve ka të dhëna se zbatohen sanksione;
- ▶ OJF-së i kërkohet të ofrojë shërbime ose përfitime me kushte të favorshme për donatorin ose një person të emëruar nga donatori;
- ▶ Pagesat janë marrë nga donatorë të njohur, por transferimi/dhënia e fondeve është kryer nga një palë e tretë e panjohur;
- ▶ Fondet janë marrë nga një formë e pazakontë pagese, pra jo nga një metodë tipike pagese si p.sh me mjete virtuale;
- ▶ Punonjësit kryejnë detyra ose punë që nuk u janë caktuar, ose kanë sjellje të pazakonta;
- ▶ Projekti i propozuar nga partnerët është i paqartë ose i mungojnë detaje teknike apo financiare;
- ▶ Struktura dhe natyra e projektit të propozuar vështirëson identifikimin e partnerit dhe verifikimit të identitetit dhe detajeve të tyre.
- ▶ Paraqitja e dokumenteve të identifikimit të rreme ose të dyshimta nga donatori, përfituesi i fondeve apo shërbimeve;
- ▶ Donatorët nuk janë shumë bashkëpunues në dhënie informacioni mbi identitetin e tyre, burimin e të ardhurave ose jep informacion të rremë ose ndryshon informacion shpesh dhe pa ndonjë justifikim të qartë ose kërkojnë nivele të panevojshme ose të pazakonta të privatësisë.
- ▶ Donatori pyet në mënyrë të përsëritur në lidhje me procedurat mbi aplikimin e rregullave kundër parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- ▶ Kërkesat që pagesat të kryhen cash nga OJF ndaj një pale të tretë të panjohur ose një organizate tjetër;
- ▶ Komunikim me email nga adresa të reja ose të pazakonta, që nuk janë në emrin e donatorit të zakonshëm ose nga dikush që nuk është pikë kontakti e rënë dakord më parë;
- ▶ Shpenzime të papritura ose të rritura të personelit.
- ▶ Propozimet përfshijnë delegimin e punës partnerëve të panjohur ose organizatave të sapoformuara;

V. MASAT E OJF PËR PARANDALIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Masat për zvogëlimin/uljen e riskut të keqpërdorimit të OJF-ve nga Financimi i Terrorizmit kryesisht merren nga organet përgjegjëse qeveritare, bazuar kjo edhe në rekomandimin 8 të FATF. Megjithatë praktikat më të mira ndërkombëtare duke përfshirë edhe FATF evidentojnë se është po aq e rëndësishme edhe marrja e masave nga vetë OJF-të.

Disa prej masave të cilat ndihmojnë OJF- të në uljen e riskut si dhe cenueshmërisë, vlerësohet të jenë:



Secila nga masat e cituara më sipër është trajtuar më vete, si më poshtë vijon, me qëllim dhënien e një orientimi OJF-vë për mbrojtjen nga risku i financimit të terrorizmit.

5.1 Transparenca

Me qëllim parandalimin abuzimin financiar dhe keqpërdorimin e burimeve dhe fondeve sugjerohet që OJF të ndërmarrin hapat si më poshtë:

- Miratimi i buxhetit vjetor nga një bord drejtues dhe aplikimi i një procesi të brendshëm për monitorimin e përdorimit të fondeve.
- Mbajtja e të dhënave financiare të plota mbi të ardhurat, shpenzimet dhe transaksionet financiare gjatë gjithë veprimtarisë së tyre, duke përfshirë edhe përdorimin përfundimtar të fondeve¹⁴.
- Pasqyrimi i qartë në program i qëllimit kur mbledhin fonde dhe sigurojnë që fondet të përdoren për atë qëllim.
- Publikimi i informacionit për aktivitetet e kryera.
- Vendosja e kriterëve për burimet e të ardhurave të tyre dhe për të përcaktuar nëse donacionet duhet të pranohen ose të refuzohen.
- Ruajtja dhe vënia në dispozicion të autoriteteve përkatëse, e të dhënave të mjaftueshme për transaksionet e brendshme dhe ndërkombëtare në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Dokumentacioni i mësipërm ndër të tjera përfshin informacion për:
 - a) qëllimin dhe objektivat e aktivitetëve të deklaruara të OJF-ve ;
 - b) identitetin e të gjithë të punësuarve dhe përfshirjen e tyre nëse ka pasur në OJF të tjera ose subjekte tregtare,
 - c) identitetin e personit/personave që drejtojnë aktivitetin e OJF-ve.

Ky informacion sugjerohet të jetë publik dhe të vihet në dispozicion të publikut ose drejtpërdrejt nga OJF-të ose nëpërmjet autoriteteve shtetërore kompetente.

5.2 Njohja e palëve bashkëpunuese dhe donatorëve

Për të parandaluar abuzimin e fondeve, OJF-të sugjerohet të marrë një sërë masash ndaj atyre individëve dhe organizatave nga të cilat përfiton donacione, u jep para ose bashkëpunon ngushtë me ta para se të hyjë në marrëdhënie ose marrëveshje, përfshirë këtu verifikime shtesë në të dhëna publike, duke përfshirë listat e sanksioneve vendase dhe ndërkombëtare.

Të dhëna të tjera të detajuara janë parashtruar më poshtë në pikën 5.8.

¹⁴ Në këtë kuadër një sugjerim mund të jetë krijimi i një sistem elektronik për menaxhimin e këtyre të dhënave, që të jetë i monitoruar nga një auditor i pavarur.

5.3 Monitorimi i programit/projektit

OJF-të sugjerohet të krijojnë kontrolle të brendshme dhe sisteme monitorimi për të siguruar që fondet dhe shërbimet po përdoren sipas qëllimit. Për shembull sugjerohet që:

- Të përcaktojnë qartë qëllimin dhe shtrirjen e aktiviteteve të tyre, identifikojnë grupet përfituese dhe marrin parasysh rreziqet e financimit të terrorizmit dhe masat për zbutjen e rrezikut përpara se të ndërmarrin projekte.
- Të mbajnë të dhëna të detajuara financiare për çdo projekt (fatura, listë furnitorësh, listë përfituesish etj.)
- Të vendosin procedura për të gjurmuar fondet, shërbimet dhe pajisjet dhe të preferojnë të kryejnë transaksione nëpërmjet sistemit bankar kur është e mundur me qëllim ruajtjen e transparencës së fondeve dhe zbutjen e rrezikut të financimit të terrorizmit.
- Të monitorojnë në baza të rregullta realizimin e projektit duke verifikuar ekzistencën e përfituesve dhe duke siguruar marrjen e fondeve.

5.4 Përdorimi i kanaleve të sigurta financiare të pagesës

Përdorimi i kanaleve bankare për kryerjen e transaksioneve financiare dhe kufizimi i kryerjes së pagesave me para në dorë, ndikon në uljen e riskut të FT.

Përdorimi i kanaleve të konsoliduar siç është sistemi bankar përbën një element sigurie shtesë, nisur kjo nga detyrimet që kanë këto si subjekte të ligjit për PPP/FT për marrjen e masave në kuadër të vigjilencës së duhur dhe zgjeruar si p.sh: të identifikojnë klientin (të përhershëm apo rastësor, person fizik, juridik apo organizime ligjore) dhe të verifikojnë identitetin e tij nëpërmjet dokumenteve, të dhënave apo informacioneve të marra nga burime të besueshme dhe të pavarura, në rastin e transfertave të parave ose vlerave, në nisje dhe në mbërritje, duhet të marrin dhe të identifikojnë emrin, mbiemrin, adresën, numrin e dokumentit të identifikimit ose numrin e llogarisë së dërguesit dhe përfituesit, si dhe emrin e institucionit financiar të përfshirë në transfertë etj.

Për më tej sillet në vëmendje se ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, parashikon se tatimpaguesit, personat fizikë/juridik tregtar, nuk mund të kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë, kur vlera e transaksionit është më e madhe se 150,000 LEK.

5.5 Njohja e palëve të treta

“Transaksionet e palëve të treta” i referohen transaksioneve kur OJF merr fonde nga, ose i kërkohet t'i dërgojë fonde, një palë të tretë përveç donatorit, përfituesit ose partnerit për të cilin OJF ka një marrëveshje bashkëpunimi apo përfituar apo dërguar fonde më parë. Për shembull:

- OJF i kërkohet nga një përfitues ose partner, t'i transferojë ato fonde një pale të tretë;
- Në rastin e një dhurimi, OJF merr në mënyrë të papritur fonde nga një llogari e palës së tretë dhe jo drejtpërdrejtë nga donatori.

Kur fondet janë siguruar nga një palë të tretë apo i vihen në përdorim kësaj të fundit, OJF-ja sugjerohet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t'u siguruar se pala e tretë po vepron në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi dhe në përputhje me veprimtarinë e vetë OJF-së. OJF-të inkurajohen të marrin hapat e nevojshme për të zvogëluar rrezikun e përdorimit të fondeve për veprimtari terroriste nga një palë e tretë, përfshirë këtu:

- ndërmarrjen e hapave të duhur për të njohur donatorët e njëkohësisht dhe përfituesit e tyre;
- kërkimin e garancive nga pala e tretë (*si një parakusht për lëvrimin e fondeve apo ofrimin e shërbimeve*), se nuk do të përdoren për financimin e aktiviteteve/organizatave terroriste.

OJF-të sugjerohet të bëjnë përpjekje për të mbledhur informacionin e mëposhtëm në lidhje me palët e treta. Ky proces përfshin kërkimin direkt të informacionit nga palët e treta, apo kryerjen e kërkimeve të pavarura në burimet e hapura.

- Në qoftë se pala e tretë është një individ, OJF-të sugjerohet të kenë në dispozicion të dhënat e mëposhtme:
 - a) Emrin/Mbiemrin, datën e lindjes dhe të dhënat e kontakteve (p.sh. numrat e telefonit, adresa postare, email etj.);
 - b) Shtetësinë dhe vendbanimin;
 - c) Emrat e personave të kontaktit të organizatave me të cilat individi punon/bashkëpunon;
 - d) Një deklaratë të objektit të veprimtarisë së organizatave të përmendura në pikën c;
 - e) Detajet e projekteve të tjera/veprimeve/iniciativave/angazhimeve në të cilat është përfshirë pala e tretë duke përfshirë informacione mbi përfituesit;
 - f) Çdo informacion tjetër që OJF mund të sigurojë mbi identitetin dhe integritetin e palës së tretë.
- Në qoftë se pala e tretë është një organizatë, OJF-të sugjerohet të kenë në dispozicion informacionin e mëposhtëm:
 - a) Emrin dhe detajet e kontaktit (p.sh. numrat e telefonit, adresën postare, adresën e-mail);
 - b) Vendi në të cilin është formuar organizata;
 - c) Një deklaratë të qëllimit kryesor të krijimit të tyre;
 - d) Dokumentet të tilla si:
 - kopje të dokumenteve ligjore të regjistrimit;
 - informacion për personat që kanë formuar organizatën dhe punojnë në të;

- informacion në lidhje me donatorët e organizatës;

e) Të dhënat e projekteve/veprimeve/iniciativave/angazhimeve të tjera të ndërmarra ose të kryera tashmë nga pala e tretë duke përfshirë informacione mbi përfituesit e këtyre veprimeve, dhe çdo informacion të arsyeshëm që siguron OJF-ja për identitetin dhe integritetin e palës së tretë.

5.6 Njohja e përfituesve të shërbimeve

OJF-të sugjerohet të verifikojnë nëse kanë informacion mjaftueshëm për subjektet për të cilët ofron ndihmë (*p.sh., komunitetin e fshatit, qytetit etj.*), të verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të lëvruara prej tyre, të kryejnë verifikime në listat e sanksioneve ndërkombëtare dhe kombëtare.

Informacioni që OJF-të marrin për përfituesit e tyre sugjerohet të ruhet dhe të përdoret në përputhje me detyrimet në kuadër të ligjeve për mbrojtjen e të dhënave. Të dhëna të detajuara janë parashtruar më poshtë në pikën 5.8.

5.7 Situatat e emergjencave

Situata të caktuara, të tilla si rastet e fatkeqësive natyrore apo urgjenca të tjera civile, mund ta bëjnë të vështirë që OJF-të të mbledhin informacion mbi donatorët/palët e treta ose përfituesit. Megjithatë, OJF-të sugjerohet se ndër të tjera të marrin në konsideratë rreziqet që mund të shoqërojnë situatën dhe brenda kontekstit të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të përcaktuar identitetin dhe integritetin e donatorëve/palëve të treta ose përfituesve.

5.8 Kryerja e trajnimeve në fushën e FT dhe e vlerësimeve të brendshme të riskut

Kryerja e trajnime për rrezikun ekspozimit ndaj financimit të terrorizmit, nga vet OJF apo edhe në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtare dhe organet publike (si DPT, AIF, QKEDH), përbën një element të rëndësishëm dhe efikas në njohjen me praktikatat me të mira ndërkombëtare dhe kombëtare të fushës. Trajnimi i stafit dhe bordeve/organeve drejtuese në mënyrë të rregullt, për parandalimin e abuzimit financiar, për të identifikuar dhe parandaluar keqpërdorimet e mundshme financiare, si dhe për të njohur rregulloret/publikimet e reja për parandalimin e financimit të terrorizmit.

OJF-të përveç sa u tha më sipër mund të bëjnë dhe një vlerësim të brendshëm risku duke analizuar donatorët e tyre, përfituesit, partnerët, punonjësit dhe vullnetarët, programet dhe shërbimet e ofruara, rajonet gjeografike ku ato operojnë si dhe kanalet e shpërndarjes dhe të ndërtojnë një matricë risku.

Vlerësimi mund të ndahet në tre kategori kryesore si:

1. Donatorë, përfitues, punonjës dhe vullnetarë

- *Njohja e donatorëve*

Këtu i referohemi kategorisë së donatorëve me të cilat OJF bashkëpunon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo edhe të vazhdueshme nëpërmjet lidhjes së kontratave përkatëse.

Për të identifikuar riskun nga kjo kategori OJF-të mund të bazohet në disa element si p.sh:

- A kryen verifikimet paraprake/duhura ndaj kësaj kategorie para se të hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi, të tilla si:
 - Nëse donatori është individ: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë, numrin e dokumentit të identifikimit, numrin personal për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, si dhe atë të barasvlershëm për shtetasit e huaj;
 - Nëse donatori është person juridik privat, që zhvillon veprimtari fitimprurëse: emrin, dokumentin që vërteton objektin e veprimtarisë, numrin unik të identifikimit të subjektit, adresën e zyrës qendrore të regjistruar dhe, nëse është e ndryshme, edhe vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë;
 - Nëse donatori është person juridik privatë, që nuk zhvillon veprimtari fitimprurëse: emrin, numrin dhe datën e vendimit të gjykatës për regjistrimin si person juridik, statutin dhe aktin e themelimit, numrin unik të identifikimit të subjektit, selinë e përhershme dhe, nëse është e ndryshme, edhe vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë, natyrën e veprimtarisë, përfaqësuesit ligjorë, si dhe personat që mbajnë pozicion drejtues vendimmarrës.
 - Nëse donatori është organizim ligjor¹⁵: informacion sipas pikave më lart për themeluesit, përfituesin, kujdestarin ose mbi personin që ushtron kontroll faktik mbi to;
 - Nëse donatori operon nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor ose me prokurë: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë, vendbanimin e përkohshëm (nëse ka) dhe të përhershëm, llojin dhe numrin e dokumentit të identifikimit, numrin personal për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, si dhe atë të barasvlershëm për shtetasit e huaj, kopjen e aktit të përfaqësimit.

- A kryen kontrole në listat e sanksioneve të cilat janë të disponueshme në burime të hapura në organet që i nxjerrin to si BE apo OKB, por edhe të publikuara në faqen zyrtare të Agjencisë së Inteligjencës Financiare¹⁶. Listat e sanksioneve, ku kryhen verifikime mbi donatorët/palët e treta, përfituesit, për anëtarë të stafit, janë:

¹⁵ Neni 2 I ligjit nr 9917 datë 19.05.2008 i ndryshuar 'Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit' i ndryshuar "Organizime ligjore" janë trustet apo marrëveshjet e tjera të ngjashme.

¹⁶ <https://fiu.gov.al/>

Sanksionet ndërkombëtare të OKB të personave dhe subjekteve që i nënshtrohen masave kufizuese nga Këshilli i Sigurimit

Lista e personave të shpallur sipas procedurës së brendshme në Shqipëri

Sanksionet e BE

- A kryen verifikime shtesë në rastet kur individët/subjektet e kësaj kategorie jetojnë/ operojnë në juridiksione me rrezik të lartë apo pranë zonave të konfliktit të tilla si: informacion për të kuptuar burimin e fondeve, të verifikojnë nëpërmjet informacionit publik ose me mjete të tjera reputacionin e tyre (p.sh nëse ka ndonjë informacion publik që lidh klientin tuaj ndonjë aktivitetin të jashtëligjshëm), etj.
- *Njohja e përfituesit të fondeve*

OJF-ja sugjerohet të identifikojë dhe të mbajë të dhënat të sakta dhe të plota mbi identifikimin e secilit prej përfituesve të fondeve sipas elementëve të parashtruar si më sipër për donatorët për shpërndarjen e ndihmës me para cash, transfertë, shërbime ose kontribute në natyrë.

Në rast se përfituesi është një organizatë/grup personash, OJF-ja donatore sugjerohet të ketë njohuri për profilin e detajuar dhe të dhënat e kësaj organizate. OJF-ja sugjerohet të marrë masa të nevojshme që do të sigurojë që përfituesit e saj të mos jenë të lidhur me ndonjë aktivitet të dyshuar terrorist.

- *Të dhëna për punonjësit dhe vullnetarët*

OJF-ja sugjerohet të kërkojë dhe të mbajë të dhëna për punonjësit e saj (si për shtetasit shqiptarë dhe për ata të huaj), si p.sh (por pa u kufizuar) adresën e përhershme, adresën aktuale, kopjen e dokumentit të identifikimit, emailin, numrin e personal (NID), numrin e telefonit ose celularit, të dhëna për përvojën e mëparshme, apo edhe kryerjen e verifikimeve në burime të hapura (internet).

2. Kanalet e përfitimit dhe shpërndarjes së fondeve

Për këtë kategori OJF-të mund të analizojnë elementë si vijon:

- Çfarë kanalesh përdorin për përfitimin/shpërndarjen e fondeve, sistemin bankar, cash, metoda pagesash si paypal, monedha virtuale, etj.
- A kanë politika dhe procedura të shkruara për përdorimin apo shpërndarjen e fondeve brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë?

- A kanë volume të larta donacionesh dhe a e kanë të vështirë të identifikojnë aktivitete të dyshimta?

3. Rajonet gjeografike (vendet ku operojnë)

- A merr donacione nga individë/subjekte apo kanale të cilat jetojnë/operojnë në vende me risk të lartë?
- A zhvillon projekte në vende me risk të lartë apo afër zonave të konfliktit?

Këtu sugjerohet ti referoheni burimeve¹⁷ si më poshtë:



Deklaratave të FATF për vendet me mangësi strategjike në regjimin e tyre kundër financimit të terrorizmit, apo edhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.
<https://www.fatf-gafi.org/en/publications/High-risk-and-other-monitored-jurisdictions/Call-for-action-june-2024.html>



Raporteve të 'The Global Terrorism Index' mbi vendet me impakt më të lartë të cilat ndryshojnë herë pas here.
<https://www.visionofhumanity.org/maps/global-terrorism-index/#/>



Raporteve të përvitshme të EUROPOL
<https://www.europol.europa.eu/publications-events/main-reports/tesat-report>



Të dhënave nga burime të hapura (internet) për vendet që përbëjnë zona konflikti, janë në afërsi zonash konfliktesh apo vende ku njihen se operojnë terroristët.

Pas vlerësimit të secilës prej kategorive të mësipërme, për të pasur një panoramë më të qartë të nivelit të riskut që OJF ka ndaj FT, mund të krijohet një matricë risku me dy dimensione duke vlerësuar:

- Probabilitetin e ndodhjes së një ngjarje të konsideruar me risk për FT;
- Pasojat që do të kishte tek OJF nëse ky element/ngjarje risku ndodh.

¹⁷ Listë e cila nuk është kufizuese.

Shembull matrice Risku:

PASOJA

→

		E ulët	E Moderuar	Madhore	Ekstreme
Probabiliteti	Shume i lartë				
	I Lartë				
	I Moderuar				
	I ulët				

Risk i ulët **Risk Mesatar** **Risk i lartë** **Risk shumë i lartë**

Identifikimi i kategorive me risk të lartë apo edhe shumë të lartë, pasohet më tej me aplikimin e masave shtesë të kontrollit të rrezikut, të cilat sugjerohen të përfshihen në procedurat e brendshme për të parandaluar keqpërdorimin e OJF për qëllime terroriste.

Në këtë kuadër sugjerohet që:

- Të informohen drejtuesit e nivelit të lartë mbi riskun e rezultuar, për marrjen e vendimeve lidhur me politikat, procedurat, dhe proceset që ndikojnë në kontrollin dhe zvogëlimin e këtyre rreziqeve;
- Monitorimi i marrëdhënies;
- Mbajtjen e dokumentacionit mbështetës;
- Vlerësimin për raportim si të dyshimtë të rastit pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare.

Në lidhje me pikën e fundit sjellim në vëmendje:

Sipas ligjit nr.157/2013 ‘Për masat kundër financimit të terrorizmit’, çdo person që ka dijeni për veprime financiare, transaksione, fonde ose veprime të tjera, të kryera apo që tentohet të kryhen, që kanë për qëllim kryerjen apo financimin e veprave terroriste, është i detyruar që, pa njoftim paraprak dhe përfshirje të personave të dyshuar apo të prekur, të njoftojë menjëherë Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

Pavarësisht se ky ligj nuk ka detyrime specifike për OJF, ka të tilla për çdo person, duke nënkuptuar edhe OJF të cilat klasifikonin si persona juridik. Më sipër shtjellohen kontrollet që duhet të kryhen në listat e personave të shpallur, të cilat në mënyrë integrale dhe të përditësuar gjenden në faqen e internetit të AIF.

VI. ROLI I AGJENCISË SË INTELIGJENCËS FINANCIARE

AIF shërben si njësi e specializuar financiare administrative për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në zbatim të ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 “*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*” i ndryshuar dhe ligjit nr.157/2013 ‘*Për masat kundër financimit të terrorizmit*’. AIF funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit kuadri ligjor i sipërpërmendur, parashikon një sërë subjektesh si bankat, shoqëritë e transfertave, noterë, shoqëri ndërtimi, zyrat e këmbimeve valutore, etj., të cilët kanë detyrime për marrje masash për identifikimin e klientëve të tyre /klientëve potencialë e më tej monitorimin, sigurimin, mbajtjen e të dhënave për burimin e fondeve, të përcaktimit të risqeve brenda subjektit, të trajnimit të punonjësve të tyre, implementimin e sanksioneve ndërkombëtare për personat e shpallur, *të raportimit pranë AIF të aktiviteteve të dyshimta (RAD)* etj.

Për më tej sipas ligjit nr.157/2013 ‘Për masat kundër financimit të terrorizmit’ i ndryshuar, çdo person që ka dijeni për veprime financiare, transaksione, fonde ose veprime të tjera, të kryera apo që tentohet të kryhen, që kanë për qëllim kryerjen apo financimin e veprave terroriste, është i detyruar që, pa njoftim paraprak dhe përfshirje të personave të dyshuar apo të prekur, të njoftojë menjëherë Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

Siç dihet OJF nuk janë subjekt referuar parashikimeve të ligjit. nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar, mirëpo ashtu siç është cituar më sipër, ka detyrime për raportim si çdo individ në kuadër të ligjit. nr.157/2013 ‘Për masat kundër financimit të terrorizmit’, i ndryshuar.

Për më tej një nga funksionet e tjera të AIF është edhe organizimi dhe marrja pjesë, së bashku me institucionet publike dhe private, në veprimtari trajnuese, për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, si për subjekte raportuese por edhe në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të publikut.

Në këtë kuadër AIF përveç se publikon tipologji të lidhura me FT, realizon trajnime për subjektet raportuese në bashkëpunim edhe me Autoritet Mbikëqyrëse është e gatshme për trajnime, tryeza diskutimi të grupuara, me pjesëmarrje nga sektori i OJF, në kuadër të ndërgjegjësimit të mëtejshëm në fushën e PP/FT.

VII. ROLI I QENDRËS KUNDËR ESKTREMIZIT TË DHUNSHËM

Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm është institucioni shtetëror kryesor për zhvillimin e politikave dhe koordinimin në nivel kombëtar, në kuadër të realizimit të iniciativave për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm, ndjekjen e proceseve të rehabilitim-riintegrim dhe risocializimit të kthyerve nga zonat e konfliktit Siri-Irak si dhe për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve qendror/lokalë dhe praktikuesve të vijës së parë të përfshirë në përpjekjen për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri. QKEDH ndihmon në zhvillimin dhe implementimin e bazës ligjore për të përballuar këtë sfidë komplekse që përfshin një qasje multisektoriale nga pushteti lokal, organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile dhe individët.

Roli i QKEDH-së është të realizojë, mbikëqyrë dhe koordinojë projekte dhe aktivitete që synojnë parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm, përfshirë ri-integrimin e individëve të rikthyer nga zonat e konfliktit. QKEDH ka për qëllim të ndihmojë në ndarjen e praktikave më të mira dhe në zhvillimin e përgjigjeve efektive ndaj ekstremizmit të dhunshëm, duke siguruar që këto aktivitete të jenë të koordinuara dhe të mbështesin një qëllim të përbashkët.

Për të arritur këto objektiva, QKEDH-ja përqendrohet në ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe në ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të vijës së parë, duke përfshirë sektorët shtetërorë, organizatat e shoqërisë civile dhe individët. Aktivitetet e QKEDH-së përfshijnë organizimin e konferencave, trajnimeve, workshop-eve dhe hartimin dhe implementimin e strategjive për të adresuar, parandaluar dhe përballuar ekstremizmin/ ekstremizmin e dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm.

Në këtë kontekst, QKEDH-ja bashkëpunon ngushtë me organizatat e shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë për zhvillimin e projekteve dhe iniciativave që adresojnë ekstremizmin e dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm. Kjo përfshin ndihmën për financim, mbështetje teknike dhe orientim në implementimin e aktiviteteve. Për më tepër, QKEDH-ja mbikëqyr dhe koordinon aktivitete të ndryshme, duke siguruar që të gjitha përpjekjet të jenë në përputhje me objektivat strategjike për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit.

Gjithashtu, QKEDH në kuadër të zbatimit të Planit të Përbashkët të Veprimit (JAP) të nënshkruar nga Komisioni Evropian me autoritetet shqiptare, në kuadër të integrimit të Shqipërisë në BE si dhe në zbatim të konventave me partnerë ndërkombëtarë të UN, bashkëpunon me donatorët për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm.

Për bashkëpunimin midis OJF që kanë fokus zhvillimin e projekteve dhe iniciativave që adresojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe QKEDH është e rëndësishme:

1. Njohja e bazës ligjore:

- Është e rëndësishme që OJF-të të kenë njohuri të sakta lidhur me fushën e radikalizmit, ekstremizmit/ ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm, duke mos u mjaftuar vetëm në marrjen dijeni për legjislacionin përkatës por gjithashtu edhe në trajnimin e stafeve për përvetësimin e tij, me qëllim që të mbështesin QKEDH në zbatimin e VKM-së nr.81 datë 14.02.2023 “Për miratimin e strategjisë ndër-sektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2023–2025 dhe të planeve të veprimit 2023–2025”, por jo vetëm.

2. Raportimi dhe Transparenca:

- Raportimi rregullisht i OJF pranë QKEDH-së si edhe autoritetet shtetërore përkatëse mbi aktivitetet dhe rezultatet e tyre, duke përfshirë përdorimin e fondeve¹⁸ dhe ndikimin e projekteve. OJF-të duhet të krijojnë sisteme të brendshme të raportimit dhe monitorimit për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

3. Bashkëpunimi dhe Koordinimi:

- Rëndësi merr bashkëpunimi i OJF dhe koordinimi i aktiviteteve të tyre me QKEDH-në dhe me aktorët e tjerë të përfshirë në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit/ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm. OJF-të përfshihen në grupe pune ose platforma të organizuara nga QKEDH për të ndarë praktikat më të mira dhe për të zhvilluar ide/përgjigje të përbashkëta ndaj sfidave.

4. Respektimi i Standardeve dhe Politika të Sigurisë:

- Respektimi nga OJF i standardeve të larta të sigurisë dhe implementimi i politikave dhe procedurave për të parandaluar abuzimet dhe për të siguruar një përdorim të drejtë dhe të ligjshëm të fondeve. OJF-të duhet të zhvillojnë dhe të zbatojnë politika të forta për menaxhimin e fondeve dhe të kryejnë auditime të rregullta për të siguruar përputhshmëri me standardet ligjore.

Për të arritur objektivat e synuara lidhur me këtë fushë, është e nevojshme që OJF-të të:

- Të aplikojnë praktikat më të mira në menaxhimin e projekteve dhe në parandalimin e financimit të terrorizmit, duke ndarë përvojat dhe mësimet e nxjerra me QKEDH-në.

¹⁸ OJF raportojnë mbi zbatueshmërinë e aktiviteteve për të qenë transparent me fondet si dhe të ecin në një linjë me planin e veprimit të institucionit që zbaton projektin.


- Të ofrojnë analiza dhe raportime mbi trendet dhe sfidat e ekstremizmit/ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm, që ndihmojnë në formësimin e politikave dhe strategjive.
- Të angazhohen në programe rehabilitimi dhe ri-integrimi për individët e rikthyer nga zonat e konfliktit, duke ofruar mbështetje dhe shërbime që ndihmojnë në riintegrimin e tyre në shoqëri.
- Të marrin pjesë në trajnime dhe workshop-e të organizuara nga QKEDH-ja për të përmirësuar dhe ngritur kapacitetet e tyre si dhe për të kontribuar në zhvillimin e përgjigjeve efektive ndaj nevojave në fushën e parandalimit të radikalizmit dhe ekstremizmit/ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm.

VIII. TIPOLOGJI

Marrë në konsideratë se në Shqipëri nuk ka pasur raste të materializuara për përfshirje të OJF në skema të financimit të terrorizmit, më poshtë paraqiten disa tipologji të marra në raporte ndërkombëtare.


Tipologji 1. Mbledhje dhe dërgimi i fondeve drejt zonave të konfliktit

Një Organizatë jofitimprurëse, u dyshua për mbledhjen dhe shpërndarjen e burimeve financiare për një organizatë terroriste me qendër në një vend që ushtronte aktivitetin në një zonë konflikti. Gjatë një periudhe pesë vjeçare, kjo organizatë ka kryer një numër të konsiderueshëm transfertash elektronike për personat dhe subjektet në vende të ndryshme, përfshirë këtu dhe një organizatë bamirëse, për të cilën dyshohej për lidhjet me një grup terrorist. Gjatë të njëjtës periudhë kohore, shumica e parash depozitoheshin në llogarinë bankare të kësaj organizate. Burimi i tyre ishte i panjohur dhe identiteti i dërguesve në shumicën e rasteve ishte i paqartë. Depozitimet me para në dorë në llogaritë bankare të organizatës shoqëroheshin me blerje të kartave bankare apo dhe transferimin e fondeve jashtë vendit.




Tipologji 2. Depozitime me para në dorë nën pragun e raportimit

Një kompani ishte përfituese e një numri të konsiderueshëm të depozitimeve me para në dorë, nga shumë organizata bamirëse (për shërbime këshillimi) dhe dy individë, të cilët banonin në rajone të përfshira në zona konflikti mes forcave terroriste. Në llogarinë e njërit prej këtyre dy personave, ishin kryer depozitime të fondeve nën pragun e raportimit dhe burimi i tyre ishte i panjohur. Fondet e mbledhura në llogaritë e kompanisë, më pas transferoheshin për një organizatë bamirëse që ishte aktive në një rajon konflikti, përpara se të shpërndaheshin për bamirësi të tjera, për disa prej të cilave dihej se ishin të lidhura me grupe të njohura militantësh të përfshirë në akte terroriste.




Tipologji 3. Përdorimi i fondeve të bamirësisë për qëllime terroriste

Një OJF vendase organizonte mbledhjen e fondeve, të cilat në dukje do të përdreshin për ndihmë humanitare në një zonë konflikti. Për këtë qëllim u përdorën kutitë e dhurimeve, të vendosura në disa institucione fetare dhe fondet e mbledhura administroheshin në një llogari bankare të organizatës. Themeluesi i OJF, dyshohej se fondet e mbledhura i përdorte për të mundësuar aktivitetet terrorizmi dhe jo për qëllimet humanitare të deklaruar prej saj. Një hetim nga organet e zbatimit të ligjit rezultoi në arrestimin e themeluesit të OJF, për aktivitetet terroriste dhe një pjesë e konsiderueshme e fondeve të mbledhura u sekuestruan.




Tipologji 4. Përdorimi i fondeve për qëllime terroriste

Dy kompani të licencuara të cilat operonin në shtetin "Alpha" gjatë një periudhe 1 vjeçare kishin përfituar rreth 5,000,000 EUR nëpërmjet transfertave dhe çeqeve nga OJF të huaja që operonin në 3 shtete të ndryshme A, B dhe C. Nga verifikimet e kryera nga FIU i atij shteti në bankat që këto kompani kishin llogari u evidentuan se për një periudhë 2 vjeçare nga llogaritë e shoqërive ishin transferuar në llogari të tjera nëpërmjet çeqeve dhe ishin tërhequr cash rreth 12,700,000 EUR. Gjithashtu u konstatua se e njëjta kompani që ka marrë fonde nga kompania X kishte marrë edhe nga kompania Y pasi transaksionet ishin autorizuar nga të njëjtat pronarë apo të njëjtët nënshkrues të llogarive. Për më tepër kompanitë që merrnin fondet kishin edhe transaksione që nuk përputheshin me nivelit e tyre të qarkullimit. Nga verifikimet e mëtejshme u identifikua se OJF-të e huaja kishin lidhje me një organizatë terroriste si dhe dyshohej për një lidhje me një grup tjetër terrorist i cili ishte i përfshirë në listën terroriste të shtetit "Alpha".



Tipologji 5. Mbledhja e fondeve për mbështetje të qëllimeve terroriste

Një OJF lokale e paregjistruar “OJF A” organizoi një ngjarje të madhe publike për të mbledhur fonde. Fondet u mbledhën nëpërmjet transfertave dhe depozitimeve cash në llogarinë e një OJF-je tjetër “OJF B” e cila ishte e regjistruar. Në dukje OJF-të ishin dy subjekte të veçanta por individët të cilët menaxhonin “OJF A” menaxhonin edhe llogarinë e “OJF B” dhe ishin të autorizuar për të tërhequr dhe transferuar fonde. “OJF A” e përdori gradualisht llogarinë për të tërhequr fonde për qëllime të ndryshme. Nga verifikimet e kryera u evidentua se disa prej fondeve ishin dërguar në një zonë konflikti e cili ngriti dyshime se një pjesë e këtyre parave u dërgua për grupet terroriste aktive në atë zonën e konfliktit.



UDHËZUES OJF MBI FT

IX. PUBLIKIME NË NIVEL VENDI DHE NDËRKOMBËTAR

Në kuadër të këtij Udhëzuesi vlen të përmenden për tu mbajtur në konsideratë publikimet si më poshtë:

- *International Standards on Combating Money Laundering and the Financing of Terrorism & Proliferation (The Interpretive Note to Recommendation 8 within the FATF Recommendations 2012, updated 2023);*
- *Combating the Abuse of Non-Profit Organizations (Recommendation 8) (2015), e njohur si “Best Practices Paper” or “BPP”;*
- *Combating The Terrorist Financing Abuse Of Non-Profit Organisations Best Practices FATF 2023;*
- *The Terrorist Financing Risk Assessment Guidance (2019) FATF, e cila përmban edhe një kapitull për vlerësimin e riskut për FT të OJF;*
- *The Risk of Terrorist Abuse in Non-Profit Organizations (2014), e njohur si ‘Typologies Paper’ or ‘Typologies’;*
- *Udhëzues Praktik për të parandaluar abuzimin e mundshëm me organizatat jofitim prurëse të publikuar nga ‘Partners Albania’, 2023;*
- *Being Resilient, A Guide to Protecting Your Organization from the Threat of Terrorism Financing Abuse, Dhjetor 2023, FSVC Albania ;*
- *Tipologjitë e publikuara në raportet vjetore në faqen zyrtare të AIF (<https://fiu.gov.al/raporte/>);*
- *Udhëzues mbi Sanksionet financiare në lidhje me terrorizmin, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë (<https://fiu.gov.al/publikime-aktivitete/publikime/>);*
- *Përmbledhje tipologjish të financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë (<https://fiu.gov.al/publikime-aktivitete/publikime/>);*
- *Përmbledhje tipologjish për financimin e terrorizmit dhe pastrimit të parave nëpërmjet OJF (<https://fiu.gov.al/publikime-aktivitete/publikime/>);*